

ABU SEMAN  
Nr. Prot. 681  
Dt 14/07/2017



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman

VENDIM

Nr. 29 Datë 29/06/2017

**Për miratimin e lejes për shfrytëzimin të burimit ujor KP 134/2 në lumi Osum në Polican Bashkia Skrapar për ujë teknologjik nga subjekti "SPIECAPAG"**

Në mbështetje të ligjit 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore" neni 5, neni 12 pika 1, neni 13 pika 2 d, neni 41, neni 50 pika 2. Vendimit Nr 416 date 13.05.2015 Keshillit të Ministrave "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumentave shoqërore, afatit të vlefshmerisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore". Vendimit të Keshillit Kombëtar të Ujit Nr 5 date 16.02.2016 "Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Keshillit të Basenit Ujor si dhe Vendimi të Keshillit Kombëtar të Ujit Nr 6 date 16.02.2016 "Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Agjencisë së Basenit Ujor" Keshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman.

VENDOSI:

**Miratimin e lejes për shfrytëzimin të burimit ujor KP 134/2 në lumi Osum në Polican Bashkia Skrapar për ujë teknologjik nga subjekti "SPIECAPAG"**

Kordinatat e pikës KP 134/2 janë si më poshtë:

X = 44 20 652.9      Y = 44 99 000.7      Z = 118 m

Prurja mesatare e muajit më të thatë është  $Q_{mes} = 4.4 \text{ m}^3/\text{sek}$

Sasia që jepet në përdorim është  $Q = 111 \text{ l}/\text{sek}$

Prurja ekologjike nuk përben problem pasi sasia e ujit që do merret është shumë e vogël në krahasim me prurjet e lumit

Shkarkimet do të bëhen po në lumin Osum

Ngarkohet AUB Seman për zbatimin e këtij vendimi.

KRYETARI I KBU  
SEMAN  
Vasil Bregu

PËR GJEGJËSI AUB SEMAN

